ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **SHËRBIMI KORREKTUES I KOSOVËS**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **215/33600-26-7479-1-2-1**

Sa i përket tenderit për **Furnizim me pajisje të kuzhinave dhe pajisje të laventarisë**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	**Osa -Termosistem**
NUI	**810394255**
Adresa	**Rr Bernjak pn**
Vendi	**Rahovec**
Kodi postar	**21000**
Numri Telefonit	**+383 49 200860**
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	**Selami OSA**
Adresa elektronike	**osatermosistemprokurim@gmail.com**
Data e parashtrimit të ankesës	**16.11.2026**

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-it

Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Furnizim me pajisje të kuzhinave dhe pajisje të laventarisë

Njoftimi për kontratë (B05) për aktivitetin e prokurimit "Furnizim me pajisje të kuzhinave dhe pajisje të laventarisë" – Ritender, nr. 215/33600-26-7479-1-2-1, procedurë e hapur, kontratë furnizimi me vlerë të mesme, me vlerë të parashikuar 60,000.00 €, është publikuar më 07.09.2026 në platformën e-Prokurimi. Me B54 të datës 25.09.2026 janë korrigjuar afatet dhe specifikat teknike.

Afati i fundit për dorëzimin e tenderëve dhe hapja e tenderëve: 07.10.2026, ora 13:30, përmes platformës e-Prokurimi. Kriteri për dhënien e kontratës: tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

Njoftimi mbi vendimin e AK (B58) është publikuar më 27.10.2026: kontrata i është dhënë OE Liria SH.P.K. në vlerë prej 54,852.00 €. Vendimi i AK mbi kërkesën për rishqyrtim: nr. prot. ZP-66/2026, datë 04.11.2026.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ ***Jo*** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Më 02.11.2026, brenda afatit (neni 108/A, paragrafi 3.2 i LPP-së; neni 60.1 (b) i RRPP-së), OSA TERMOSISTEM SH.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në formularin F02 përmes platformës e-Prokurimi. Me Vendimin nr. prot. ZP-

66/2026 të datës 04.11.2026, Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit e ka refuzuar kërkesën si të pabazë dhe ka vërtetuar vendimin për dhënie të kontratës. Kopja e vendimit bashkëngjitet (pika 10 e).

Pretendimet në këtë ankesë janë të njëjta me ato të kërkesës për rishqyrtim (neni 64.2 i RRPP-së). Në pikën 8, secili pretendim paraqitet (A) fjalë për fjalë siç është paraqitur në kërkesën për rishqyrtim dhe (B) me argumente shtesë, vetëm si përgjigje ndaj arsyetimit të AK-së në Vendimin ZP-66/2026.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar (LPP):

- Neni 6 – Ekonomiciteti dhe efikasiteti; neni 7, paragrafi 1 dhe 2 – Barazia në trajtim / jo-diskriminimi;
- Neni 13, paragrafi 4 – Përdorimi i gjuhëve në dokumentet e prokurimit;
- Neni 57, paragrafi 4.2 – Sigurimi i tenderit (periudha e vlefshmërisë e përcaktuar në dosje);
- Neni 59, paragrafi 2 dhe 4 – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve (sqarimet; tender i përgjegjshëm; devijime të vogla);
- Neni 60 – Kriteret për dhënien e kontratës;
- Neni 69, paragrafi 2.1 dhe 2.4 – Aftësia teknike dhe/ose profesionale (referencat; përshkrimi i produkteve);
- Neni 72, paragrafi 3 – Dokumentacioni dhe informacioni shtesë;
- Neni 108/A – Vendimi i arsyetuar mbi kërkesën për rishqyrtim (pretendime të patrajtuara).

Rregullorja Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024 (RRPP):

- Neni 7.4 dhe 7.6 – Qasja në dokumente;
- Neni 28.1 (b) dhe 28.6 – Sigurimi i tenderit; neni 30.1 dhe 30.2 (b) – Validiteti i tenderit;
- Neni 38.2 dhe 38.3 – Sqarimi i tenderëve;
- Neni 40.2, 40.6, 40.7, 40.12 dhe 40.13 – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve;
- Neni 63 – Vendimi i AK mbi kërkesën për rishqyrtim.

Udhëzuesi i KRPP-së Nr. 002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e Udhëzuesit Nr. 001/2023 për prokurimin publik – **pika 10.1**.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

I. Legjitimimi dhe afati

OSA TERMOSISTEM SH.P.K. ka dorëzuar tender në këtë aktivitet dhe me letrën B42 është eliminuar; rrjedhimisht është "palë e interesuar" sipas nenit 4, paragrafi 1.26 të LPP-së. Kërkesa për rishqyrtim është parashtruar në afat më 02.11.2026 dhe është refuzuar me Vendimin ZP-66/2026 të datës 04.11.2026. Sipas nenit 109 të LPP-së dhe nenit 64.1 të RRPP-së, ankesa parashtrohet brenda dhjetë (10) ditëve; dita e dhjetë bie të shtunën (14.11.2026), prandaj sipas nenit 5, paragrafi 2 të LPP-së afati zgjatet deri më 16.11.2026.

II. Vendimi i kundërshtuar

Me B58 të datës 27.10.2026 kontrata i është dhënë OE Liria SH.P.K. (54,852.00 €). Oferta e OSA TERMOSISTEM SH.P.K. (49,954.00 €) – oferta më e lirë pas Msi SH.P.K. – është eliminuar me arsyetimin se "vlefshmëria e tenderit është kërkuar për 60 ditë ndërsa keni ofruar validitet të ofertave për 90 ditë" dhe se sigurimi i tenderit nuk është 30 ditë më i gjatë se vlefshmëria e ofertës, me referencë në vendimin OSHP 2026/0013 dhe nenin 28.6 të RRPP-së. Me Vendimin ZP-66/2026 AK e ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim dhe e ka vërtetuar vendimin për dhënie të kontratës.

III. Pretendimi 1 – Oferta e OSA TERMOSISTEM SH.P.K. është e përgjegjshme dhe është eliminuar padrejtësisht (LPP 57.4.2, 59.4, 7; RRPP 28.1(b), 28.6, 30.2(b), 40.2, 40.7, 40.12)

A. Siç është paraqitur në kërkesën për rishqyrtim (02.11.2026):

- **Sigurimi i tenderit është në përputhje të plotë me Dosjen e Tenderit.** Sipas nenit 57, paragrafi 4.2 të LPP-së, AK përcakton në dosje "periudhën e nevojshme të vlefshmërisë për sigurimin e tenderit". AK e ka përcaktuar këtë në FDT 13.2 dhe B05 IV.3.4: 1,000 € me vlefshmëri 90 ditë. OSA TERMOSISTEM SH.P.K. ka dorëzuar policën Scardian nr. 080098, 1,000.00 €, me vlefshmëri 90 ditë nga 07.10.2026 – saktësisht sipas kushtit të AK-së. Dosja, B05 dhe B54 nuk përmbajnë kërkesë që periudha e sigurimit të llogaritet nga vlefshmëria e deklaruar nga tenderuesi.
- **Neni 28.6 i RRPP-së është përmbushur.** Sipas nenit 28.1 (b) të RRPP-së, sigurimi mbulon që "tenderi është valid për **periudhën e kërkuar të validitetit**". Periudha e kërkuar nga AK (FDT 22.1, B05 IV.3.5) është 60 ditë; sigurimi prej 90 ditësh e mbulon këtë periudhë plus tridhjetë (30) ditë pas skadimit të saj. Vetë AK e ka llogaritur kështu sigurimin (60 plus 30 = 90 ditë).
- **Vlefshmëria më e gjatë është e lejuar.** Sipas nenit 30.2 (b) të RRPP-së, vlefshmëria për kontratat me vlerë të mesme është "**në minimum** 60 ditë". IPT 22.1 parasheh refuzim vetëm kur tenderi "është valid për një kohë **më të shkurtër**". Vlefshmëria më e gjatë është në favor të AK-së dhe nuk i shkakton asnjë dëm apo rrezik.
- **AK ka shtuar kriter të ri.** Sipas nenit 40.2 të RRPP-së, AK nuk mund të shtojë kërkesa të reja gjatë vlerësimit; sipas nenit 40.12 të RRPP-së, tenderuesi "nuk do të diskualifikohet … në bazë të ndonjë kërkese apo kriteri që nuk është specifikuar në njoftimin e kontratës / dosjen e tenderit".

• **Praktika e OSHP-së e konfirmon këtë qëndrim.** Në vendimin **OSHP 2026/0184** (KRM Pastërtia Ferizaj, nr. KRMFe-25-11517-1-2-1), dosja e tenderit kërkonte vlefshmëri 60 ditë dhe sigurim 90 ditë – njësoj si në këtë aktivitet – ndërsa OE fitues kishte ofruar vlefshmëri **120 ditë** me sigurim vetëm **90 ditë**. Paneli Shqyrtues konstatoi se "sikurse validiteti i ofertave edhe sigurimi i tenderit është brenda afateve të përcaktuara në NJK dhe DT" dhe la në fuqi vendimin B58. Po ashtu, në vendimin **OSHP 2025/0505** (Spitali Ferizaj, nr. 220-25-331-2-1-1), ku dosja kërkonte 120 ditë vlefshmëri dhe OE fitues kishte ofruar **365 ditë** vlefshmëri me sigurim 120 ditë, eksperti shqyrtues vlerësoi se pretendimi për validitetin "nuk qëndron" dhe Paneli e la fituesin në fuqi. Rasti i OSA TERMOSISTEM SH.P.K. është edhe më i favorshëm: sigurimi prej 90 ditësh përputhet saktësisht me kërkesën e AK-së dhe mbulon periudhën e kërkuar të validitetit plus 30 ditë.

- Vendimi OSHP 2026/0013, në të cilin mbështetet AK, nuk e përjashton këtë interpretim: OSHP-ja vetë ka vendosur ndryshe në raste me rrethana të njëjta (2026/0184; 2025/0505). Për më tepër,

sipas nenit 40.12 të RRPP-së, kriteri vendimtar mbetet ai që është specifikuar në dosjen e tenderit – dhe dosja kërkonte sigurim 90 ditë, të cilin OSA TERMOSISTEM SH.P.K. e ka përmbushur.

- Edhe nëse do të konsiderohej mospërputhje, ajo nuk është "largim thelbësor" sipas nenit 40.7 të RRPP-së, por devijim i vogël sipas nenit 59.4 (ii) të LPP-së, që nuk mund të sjellë eliminimin e ofertës.

B. Argumente shtesë pas Vendimit të AK nr. ZP-66/2026 (04.11.2026):

- **Pasaktësi faktike.** AK pohon se vendimet e OSHP-së të cituara "nuk kanë validitetin dhe sigurimin e njëjtë". Ky pohim është i pasaktë: në rastin 2026/0184 kërkesat e dosjes ishin identike (60 ditë vlefshmëri / 90 ditë sigurim), ndërsa pozita e OE fitues ishte edhe më e dobët se e OSA TERMOSISTEM SH.P.K. (sigurimi 90 ditë, më i shkurtër se vlefshmëria e deklaruar 120 ditë). AK nuk ka identifikuar asnjë dallim konkret.
- **Mungesë arsyetimi.** AK nuk u është përgjigjur argumenteve të bazuara në nenin 57.4.2 të LPP-së dhe në nenet 28.1 (b), 30.2 (b) dhe 40.12 të RRPP-së, të ngritura shprehimisht në kërkesë; ajo vetëm e ka përsëritur tekstin e nenit 28.6.
- **Neni 28.6 i drejtohet AK-së.** AK pohon se kërkesa "buron drejtpërdrejt nga dispozita ligjore". Por neni 28.6 i RRPP-së, në lidhje me nenin 57.4.2 të LPP-së, i drejtohet AK-së kur e përcakton sigurimin në dosje. AK e ka zbatuar duke kërkuar sigurim 90 ditë (60 plus 30). Tenderuesi që e përmbush pikërisht këtë kërkesë nuk mund të eliminohet me një llogaritje tjetër që nuk shfaqet askund në dosjen e tenderit.
- **Arsye e re eliminimi.** Në Vendimin ZP-66/2026 AK shton: "Oferta juaj nuk është e përgjegjshme në aspektin teknik profesional". Kjo arsye nuk ishte në letrën B42, nuk është arsyetuar dhe nuk mund të shtohet në fazën e rishqyrtimit (neni 40.2 i RRPP-së). OSA TERMOSISTEM SH.P.K. ka dorëzuar referenca publike që e tejkalojnë disa herë kërkesën minimale (ndër to MM/FSK – 249,675.02 €), deklaratën sipas FDT 3.1 dhe Aneksin 1 të nënshkruar.
- **AK nuk ka pasur asnjë rrezik.** Polica Scardian nr. 080098 është e vlefshme deri më 05.01.2027 dhe mbulon tërë periudhën e vlefshmërisë së ofertës së OSA TERMOSISTEM SH.P.K.

IV. Pretendimi 2 – Oferta e Liria SH.P.K. është e papërgjegjshme (LPP 7, 59.4, 60, 69, 72.3; RRPP 38, 40.6; Udhëzuesi 002/2024 pika 10.1)

A. Siç është paraqitur në kërkesën për rishqyrtim (02.11.2026):

2.1 Katalogu / oferta teknike. Kërkesa 2 te kapaciteti teknik (B05 III.2.4, FDT 9.1, B54) kërkon "katalog apo ofertë teknike duke përshkruar të gjitha specifikacionet teknike **të cilat i ofron** (specifikacionet duhet të jenë të kjarta dhe te detajuar)"; IPT 21.2 kërkon "përshkrim të detajuar të karakteristikave thelbësore teknike dhe performuese të secilit artikull të ofruar" (shih edhe nenin 69, paragrafi 2.4 të LPP-së).

- Dokumenti "Katalogu_Teknik_i_Perditesuar_40_Produkte" (12 faqe, krijuar më 07.10.2026) e kopjon fjalë për fjalë tekstin e Aneksit 1 të AK-së, përfshirë gabimet e dosjes ("thellësia 10 mm" te art. 2; "24x4.5cm trashsie e rrafsht 2cm" te art. 8).
- Për asnjë nga 40 artikujt nuk prezantohet prodhuesi, marka apo modeli, as fletë teknike e prodhuesit. Rrjedhimisht, në pranimin teknik (KPK nenet 18, 19 dhe 23) artikujt e liferuar nuk mund të identifikohen dhe të krahasohen me ata të ofruar, dhe nuk mund të bëhet vlerësim meritor sipas nenit 40.6 (b) të RRPP-së.
- Pa specifika të qarta e të detajuara: art. 6 dhe 7 (lugë franceze), art. 13 (blender inox), art. 21 (mashë), art. 32 (garuzhda 0.25 L) dhe art. 40 (tabaka) – vetëm "Sipas emërtimit dhe fotografisë referuese në dosjen e tenderit"; art. 20 – vetëm "dimenzione të ndryshme"; art. 22 – vetëm "dim 22cm", pa material e karakteristika.

• Art. 10 (Termos) – "diameter 35 x 40 cm, lartësia 40-45 me toleranc sipas prodhuesit": nëse OE do ta kishte identifikuar prodhuesin dhe modelin, do të jepte dimensionet e sakta, e jo intervalin e AK-së me shënimin "sipas prodhuesit".

- Fotografitë nuk përputhen me specifikat: poz. 2 "Tepsi të thella 40x60" – tenxhere me avull me disa

kate; poz. 12 "Shpakull inox" – shpatull e gjelbër për punë ndërtimore; poz. 14 "Tigan i thellë inox AISI 304, diameter 28" – kusi i vogël me veshje të errët; poz. 37 "Tepsi me vrima 600x400x150" – shportë e ngushtë kullimi për lavaman.

Sipas Udhëzuesit Nr. 002/2024, pika 10.1, kur "mungon specifikacioni teknik për mallrat e ofruara … (AK përcakton kërkesat minimale dhe maksimale të një produkti, ndërsa OE duhet të dorëzojë specifikimin e detajuar të mallrave të ofruara)" dhe kur "është dorëzuar katalogu por mungon specifikacioni teknik për mallrat e ofruara", AK duhet të "refuzojë tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm". Këtë standard e ka zbatuar vetë Shërbimi Korrektues i Kosovës dhe e ka konfirmuar OSHP-ja në aktivitetin me të njëjtin titull nr. 33600-25-4388-1-1-1 (vendimi OSHP 2025/0894, 21.10.2025). Mosaplikimi i të njëjtit standard ndaj Liria SH.P.K. shkel nenin 7, paragrafi 1 dhe 2 të LPP-së.

2.2 Referencat. B05 III.2.4, FDT 9.1 dhe B54 kërkojnë kontratë të realizuar me sukses jo me pak se 90,000.00 € për furnizime të ngjashme në tri vitet e fundit dhe: "Referencë e realizuara me Operatoret Ekonomik Privat janë të pranueshme kur të njëjtat dëshmohen me transaksione bankare apo me fatura tatimore" (shih nenin 69, paragrafi 2.1 (ii) të LPP-së).

- Nga 128 kontratat e listuara, pothuajse të gjitha janë furnizime me materiale ndërtimore, elektrike, hidrosanitare, ngrohje, perde, pelet etj. – jo furnizime të ngjashme me pajisje kuzhine dhe laventarie.
- Të vetmet të ngjashme janë me klientë privatë: nr. 127 "Hotel Ora Premium" (95,497.50 €) – asnjë referencë, faturë apo transaksion bankar;
- Nr. 128 OJQ "Zëri i Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianëve" (167,567.00 €) – vetëm letër reference nr. 34/2026, pa fatura apo transaksione bankare, dhe periudhë jokonsistente e realizimit të kontratës: në listën e kontratave të realizuara është shënuar data e nënshkrimit të kontratës 01.03.2022 dhe data e përfundimit të kontratës 21.12.2025, ndërsa në dokumentin e referencës shkruan se periudha e realizimit të kontratës është 01.02.2024–31.12.2025. Periudhat nuk përputhen.
- Sipas Udhëzuesit Nr. 002/2024, pika 10.1, kur "lista e kontratave të realizuara e dorëzuar nuk përmbush kërkesat minimale të vlerës së përcaktuar", tenderi refuzohet pa kërkuar informacion të mëtejshëm (neni 69 i LPP-së); dëshmitë që mungojnë nuk mund të krijohen pas afatit (neni 72.3 i LPP-së, neni 38.2–38.3 i RRPP-së). AK e ka eliminuar Shaip S. Haxhiu B.I. pikërisht për referenca jo të ngjashme – pranimi i referencave të Liria SH.P.K. është trajtim i pabarabartë (neni 7 i LPP-së).

B. Argumente shtesë pas Vendimit të AK nr. ZP-66/2026 (04.11.2026):

- **B.1 – AK nuk është marrë fare me pretendimet konkrete për katalogun.** AK është përgjigjur vetëm se dosja nuk ka kërkuar prodhues, markë apo model. Pretendimi ynë nuk mbështetet vetëm në këtë, por në artikujt për të cilët **nuk është ofruar fare specifikim** (art. 6, 7, 10, 13, 20, 21, 22, 32 dhe 40) dhe në **fotografitë që paraqesin mallra të tjera** nga ato të kërkuara (poz. 2, 12, 14 dhe 37). Vendimi ZP-66/2026 nuk e përmend asnjërin nga këta artikuj; në këtë pikë vendimi është i paarsyetuar, në kundërshtim me nenin 108/A të LPP-së dhe nenin 63 të RRPP-së. Këto mospërputhje janë materiale sipas nenit 40.6 (b) të RRPP-së dhe Udhëzuesit 002/2024 pika 10.1.
- **B.2 – Referenca e OJQ "Zëri i Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianëve".** AK pohon se vlera prej 167,567.00 € "i ka dëshmuar edhe me transaksione bankare". Me kërkesën për qasje në dokumente, OSA TERMOSISTEM SH.P.K. ka kërkuar shprehimisht, për tenderin e Liria SH.P.K., "lista e kontratave të realizuara dhe referencat/raportet e pranimit (**me fatura ose transaksione bankare për klientë privatë**) … dhe çdo dokument tjetër i ngarkuar", si dhe, për dokumentacionin e vlerësimit, "**të gjitha kërkesat për sqarim (nëse janë bërë) dhe përgjigjet e tyre; komunikimet e tjera me operatorët ekonomikë gjatë vlerësimit**". Zyrtarja e prokurimit që na e vuri në dispozicion dosjen deklaroi se na është dhënë dosja e plotë, pa u larguar asnjë dokument. Në dosjen e dhënë nuk gjendet asnjë transaksion bankar apo faturë për këtë referencë – vetëm letra e referencës nr. 34/2026 e datës 15.02.2026 – dhe nuk gjendet asnjë kërkesë për sqarim drejtuar Liria SH.P.K. apo përgjigje e saj.

- Sipas Formularit B66 të Liria SH.P.K. (07.10.2026), oferta përmban dhjetë (10) dokumente mbështetëse; asnjëri prej tyre nuk është transaksion bankar apo faturë, dhe OE nuk ka dorëzuar kërkesë për konfidencialitet (Aneksi 3). Rrjedhimisht, nuk ka asnjë dokument të tillë që mund të ishte mbuluar në versionin e pastruar të dosjes.
- Pra, ose transaksionet nuk janë pjesë e ofertës – dhe pohimi i AK-së në Vendimin ZP-66/2026 është faktikisht i pasaktë, ndërsa referenca nuk e plotëson kërkesën e dosjes për klientët privatë (neni 69.2.1 (ii) i LPP-së) – ose AK i ka kërkuar/pranuar ato pas përmbylljes së vlerësimit. Në rastin e dytë pranimi është i papranueshëm: pasi Komisioni i Vlerësimit ka marrë vendim dhe AK ka shpallur OE fitues me B58 (27.10.2026), AK nuk mund të kërkojë dhe as të pranojë dëshmi shtesë nga OE i shpallur fitues; sqarimet lejohen vetëm gjatë vlerësimit dhe pa ndryshim material të tenderit (nenet 59.2 dhe 72.3 të LPP-së; nenet 38.2–38.3 të RRPP-së), ndërsa mosdhënia e tyre pas kërkesës sonë të shprehur për qasje cenon nenet 7.4 dhe 7.6 të RRPP-së dhe parimin e trajtimit të barabartë (neni 7 i LPP-së). **Kërkojmë nga OSHP-ja të verifikojë** nëse transaksionet bankare janë pjesë e ofertës origjinale të dorëzuar më 07.10.2026 dhe, nëse jo, kur dhe si janë dorëzuar.
- **B.3 – Hotel Ora Premium.** AK nuk e përmend fare referencën nr. 127 "Hotel Ora Premium" (95,497.50 €), për të cilën në ofertë nuk ka asnjë referencë, faturë apo transaksion bankar.
- **B.4 – Trajtim i pabarabartë.** Me Vendimin ZP-65/2026 të datës 03.11.2026, AK e ka refuzuar kërkesën e Shaip S. Haxhiu B.I. me arsyetimin se referencat e tij private nuk shoqëroheshin me "referenca apo raporte pranimi" dhe nuk ishin furnizime të ngjashme. Ndaj Liria SH.P.K. i njëjti standard nuk është zbatuar (neni 7 i LPP-së).

V. Pretendimi 3 – Oferta e EU1 Servis SH.P.K. është e papërgjegjshme (LPP 59.4, 69, 72.3; RRPP 38.2–38.3, 40.6; Udhëzuesi 002/2024 pika 10.1)

A. Siç është paraqitur në kërkesën për rishqyrtim (02.11.2026):

- Mungon deklarata e kërkuar me FDT 3.1 ("Deklaratën për specifikacionet teknike për mallrat e ofruara të cilat përputhen me ato të përmendura në Aneksin 1"); nuk figuron në listën e dokumenteve (B66) dhe as brenda katalogut. Sipas nenit 72.3 të LPP-së, neneve 38.2–38.3 të RRPP-së dhe vendimit OSHP 2026/0013, nuk mund të dorëzohet pas afatit.
- Katalogu ("7. Katallogu per produkete me foto", 41 faqe) e përsërit fjalë për fjalë tekstin e Aneksit 1, pa prodhues e model; art. 6, 7, 13, 21 dhe 32 pa asnjë specifikë; art. 20 vetëm "dimenzione të ndryshme" (Udhëzuesi 002/2024 pika 10.1; OSHP 2025/0894).
- Mallra që nuk përputhen (neni 40.6 (b) i RRPP-së): art. 27 "Lavatriçe 10 kg" – fotografia paraqet tharëse rrobash LG me kondensator (e njëjtë me art. 26); art. 37 "Tepsi me vrima 600x400x150 mm" – tepsi e cekët pa thellësinë prej 150 mm.
- Referencat: B05 III.2.4, FDT 9.1 dhe B54 kërkojnë kontratë të realizuar me sukses jo me pak se 90,000.00 € për furnizime të ngjashme në tri vitet e fundit dhe: "Referencë e realizuara me Operatoret Ekonomik Privat janë të pranueshme kur të njëjtat dëshmohen me transaksione bankare apo me fatura tatimore" (shih nenin 69, paragrafi 2.1 (ii) të LPP-së). Operatori ekonomik nuk e ka përmbushur këtë kriter.

B. Argumente shtesë pas Vendimit të AK nr. ZP-66/2026 (04.11.2026):

- **AK nuk e ka trajtuar fare këtë pretendim.** Vendimi ZP-66/2026 nuk e përmend EU1 Servis SH.P.K. askund. Mungesa e arsyetimit për një pretendim të ngritur shprehimisht është shkelje e nenit 108/A të LPP-së dhe nenit 63 të RRPP-së.
- **Trajtim i pabarabartë:** po të zbatohej ndaj EU1 Servis SH.P.K. i njëjti standard si ndaj Shaip S. Haxhiu B.I. (Vendimi ZP-65/2026), edhe kjo ofertë do të ishte eliminuar (neni 7 i LPP-së).

VI. Pretendimi 4 – OSA TERMOSISTEM SH.P.K. është tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët (LPP 60; RRPP 40.13)

A. Siç është paraqitur në kërkesën për rishqyrtim (02.11.2026):

OE Msi SH.P.K. (42,746.00 €) është eliminuar me të drejtë për garancion 1 vit në vend të 24 muajve. OE Shaip S. Haxhiu B.I. (50,299.00 €) është eliminuar me të drejtë për referenca jo të ngjashme; përveç kësaj, katalogët e tij janë kryesisht në gjuhën italiane, frënge dhe gjermane, në kundërshtim me nenin 13, paragrafi 4 të LPP-së dhe IPT 18.1. Ofertat e Liria SH.P.K. dhe EU1 Servis SH.P.K. janë të papërgjegjshme për arsyet e mësipërme.

Rrjedhimisht, tenderi i OSA TERMOSISTEM SH.P.K. (49,954.00 €) është tenderi i vetëm i përgjegjshëm dhe me çmimin më të ulët, dhe sipas nenit 60 të LPP-së dhe nenit 40.13 të RRPP-së kontrata duhet t'i jepet OSA TERMOSISTEM SH.P.K. – 4,898.00 € më lirë se oferta e Liria SH.P.K., në përputhje me parimin e ekonomicitetit (neni 6 i LPP-së).

B. Argumente shtesë pas Vendimit të AK nr. ZP-66/2026 (04.11.2026):

• AK, në Vendimin ZP-65/2026, e ka konfirmuar eliminimin e Shaip S. Haxhiu B.I. Me pranimin e Pretendimeve 1–3, tenderi i OSA TERMOSISTEM SH.P.K. mbetet tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

VII. Kërkesa drejtuar OSHP-së

Bazuar në nenet 105, 111, 113, 114 dhe 117 të LPP-së, ankuesi i propozon Panelit Shqyrtues që:

- Ta aprovojë ankesën si të bazuar;
- Ta anulojë Vendimin e AK nr. prot. ZP-66/2026 të datës 04.11.2026 dhe B58 – Njoftimin mbi vendimin e AK të datës 27.10.2026, dhe aktivitetin ta kthejë në rivlerësim;
- Ta obligojë AK-në që në rivlerësim, përveç ofertave të Msi SH.P.K. dhe Shaip S. Haxhiu B.I., edhe ofertat e Liria SH.P.K. dhe EU1 Servis SH.P.K. t'i shpallë të papërgjegjshme, ndërsa ofertën e OSA TERMOSISTEM SH.P.K. ta shpallë të përgjegjshme dhe, si tender i përgjegjshëm me çmimin më të ulët, t'ia japë kontratën;
- Të caktojë ekspert shqyrtues dhe, sipas nevojës, ekspert teknik për krahasimin e katalogëve me Aneksin 1, si dhe të verifikojë dokumentacionin origjinal të ofertës së Liria SH.P.K. dhe çdo dokument të pranuar pas afatit për dorëzimin e tenderëve;
- T'ia kthejë ankuesit tarifën e paguar për parashtrimin e ankesës (neni 118 i LPP-së).

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

OSA TERMOSISTEM SH.P.K. ka ofruar tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët (49,954.00 €). Me eliminimin e padrejtë dhe dhënien e kontratës OE Liria SH.P.K., ankuesi rrezikon humbjen e kontratës dhe të fitimit të pritshëm nga ekzekutimi i saj, si dhe shpenzimet e përgatitjes së tenderit (përfshirë premiumin e sigurimit të tenderit) dhe të procedurës së rishqyrtimit. Njëkohësisht, AK do të paguante 4,898.00 € më shumë për të njëjtin furnizim. Ankuesi në këtë fazë nuk paraqet kërkesë për kompensim dhe kërkon që shkelja të riparohet përmes rivlerësimit.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.

b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
e) *bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
f) *Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
g) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*